

**Data: 23.04.2026**

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “PAJISJE DHE PJESË REZERVË ELEKTRIKE, ELEKTRONIKE, MEKANIKE PËR MIRËMBAJTJEN E AGREGATËVE E PAJISJEVE TË HEC FIERZË”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** PAJISJE TË NDRYSHME - 39300000-5.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 60,000,000 (Gjashtëdhjetë milion) Lekë pa TVSH ose 628,338.05 (Gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tetë pikë zero pesë) Euro pa TVSH. *Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 23.04.2026 është 95.49 Lekë/Euro.*

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

*b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

### **Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar “*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që Operatori Ekonomik ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe ne përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë operatori ekonomik ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të fondit limit.

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit :

Ligjin Nr. 29/2023 Për tatimin mbi të ardhurat (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar).

Vendim nr. 211, datë 9.4.2025 Për disa ndryshime në vendimin nr. 922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave. “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Udhëzim nr. 24, datë 6.11.2025 për disa shtesa dhe një ndryshim në udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

### **Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kjo kërkesë ka si qëllim sigurimin e faktit që operatori ekonomik ka përvojë dhe aftësi të mjaftueshme për të realizuar kontrata të ngjashme me atë që po kërkohet. Në këtë mënyrë, AK synon të sigurojë se operatori ka kapacitetin për të përmbushur kërkesat dhe për të ofruar shërbime apo produkte që janë të ngjashme në natyrë dhe në vlerë me ato që janë të parashikuara në kontratë. Përvojat e mëparshme në kryerjen e furnizimeve të ngjashme janë një indikator i rëndësishëm i aftësisë së operatorëve për të menaxhuar projekte dhe për të përmbushur afatet dhe standardet e kërkuara. Nëse një operator ka një histori të suksesshme të realizimit të kontratave të ngjashme, kjo ul mundësinë e dështimit të kontratës së re, duke e bërë procesin më të sigurt dhe më të besueshëm për palën kontraktuese.

Operatorët ekonomikë që kanë përvojë të mëparshme në fushat e ngjashme janë më të besueshëm në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve që kërkohen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për projekte që kërkojnë cilësi të lartë dhe përputhje me standardet. Përvoja e mëparshme tregon se operatori ka kapacitetin për të siguruar cilësinë dhe të përmbushë kërkesat kontraktuale.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ✚ ISO 9001 - “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- ✚ ISO 14001 - “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- ✚ ISO 45001 - “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

#### **Argumentimi:**

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata mundëson një menaxhim të mirë të cilësisë, mbrojtje të mjedisit dhe siguri të punonjësve. Këto standarde janë të rëndësishme për të siguruar që operacionet e mirëmbajtjes të jenë efikase, të qëndrueshme dhe të sigurt për të gjitha palët e përfshira.

#### **Konkretisht:**

**ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 9001 në këtë kontekst siguron që të gjitha pajisjet dhe pjesët rezervë që përdoren për mirëmbajtjen e aggregateve dhe pajisjeve janë të certifikuara për cilësinë e duhur. Standardi ndihmon në zhvillimin e procedurave për menaxhimin e proceseve të prodhimit, grumbullimit, dhe testimit të këtyre pajisjeve, duke siguruar që ato të plotësojnë kërkesat teknike dhe performancën e duhur.

**ISO 14001- “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”** - Është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e Kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

ISO 14001 në këtë kontekst siguron për të identifikuar dhe reduktuar ndikimet mjedisore që lidhen me prodhimin dhe përdorimin e pajisjeve elektrike, elektronike dhe mekanike. Kjo përfshin menaxhimin e mbetjeve, përdorimin e burimeve të rinovueshme dhe minimizimin e ndotjes së ujit dhe ajrit.

**ISO 45001- “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** - Është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

ISO 45001 në këtë kontekst siguron ndihmon në krijimin e një kulture të sigurisë dhe shëndetit në punë, duke përfshirë masa parandaluese, kontroll të rreziqeve dhe planifikim të veprimeve të reagimit për emergjencat. Ky sistem i siguron punonjësve mjedis pune të sigurt dhe rrit produktivitetin duke ulur ndjeshëm mundësinë për aksidente.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht për periudhën Shkurt 2026 - Prill 2026, jo më pak se 3 (tre) inxhinierë, nga të cilët të paktën:

- ✚ 1 (një) inxhinier mekanik;
- ✚ 1 (një) inxhinier elektrik;
- ✚ 1 (një) inxhinier elektronik.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomat e inxhinierëve;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Shkurt 2026 - Prill 2026.

### **Argumentimi:**

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

**Konkretisht:**

Për të garantuar që operimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe agregatëve të HEC Fierzë të jetë i suksesshëm dhe i sigurt, kërkohen inxhinierë në fusha të ndryshme teknike. Çdo tip agregati dhe pajisje në një HEC ka nevoja specifike për mirëmbajtje, kontroll dhe riparim, që mund të kërkojnë specialistë në fusha të ndryshme.

**1 (një) inxhinier mekanik, kërkohet pasi:**

Pajisjet mekanike në një hidrocentral janë thelbësore për funksionimin e agregateve, përfshirë turbinat, pompat dhe sisteme të tjera mekanike që shfrytëzojnë energjinë e ujit. Roli i inxhinierit mekanik është të sigurojë që këto pajisje të funksionojnë pa probleme, duke monitoruar dhe ndihmuar në riparimet e nevojshme nëse ndodhin defekte.

Ky inxhinier duhet të ketë aftësitë dhe njohuritë për të përcaktuar dhe zbatuar procedura për inspektimin dhe riparimin e pjesëve mekanike, kontrolluar performancën e turbinave dhe sistemeve mekanike të tjera për të parandaluar ndalimet e papritura, të përdorur mjete dhe teknika për diagnostikimin e problemeve mekanike dhe për zgjidhjen e tyre me shpejtësi.

**1 (një) inxhinier elektrik, kërkohet pasi:**

Njësia e Prodhimit HEC Fierzë ka një mori pajisjesh elektrike të ndërlikuara, duke përfshirë sisteme të transformatorëve, linjat e energjisë, dhe kontrollin e tensioneve të larta dhe të ulëta. Roli i inxhinierit elektrik është të sigurojë që të gjitha këto sisteme funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurt.

Ky inxhinier është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve elektrike të HEC, kontrollin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe monitorimin e performancës së agregatëve elektrikë, zbatimin e procedurave për parandalimin e ngarkesave të tepërta dhe mbrojtjen nga dështimet e mundshme elektrike dhe përdorimin e sistemeve të automatizuar për monitorimin dhe menaxhimin e funksionimit të pajisjeve elektrike.

**1 (një) inxhinier Elektronik, kërkohet pasi:**

Roli i inxhinierit elektronik është thelbësorë për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektronike të përdorura në HEC, si për shembull për sistemet e kontrollit dhe monitorimit të agregatëve dhe pajisjeve.

Sistemet elektronike shpesh janë të lidhura me automatikën dhe kontrollin në distancë të operacioneve, dhe për këtë arsye, kërkohet ky inxhinier për përcaktimin dhe riparimin e problemeve elektronike që mund të ndikojnë në funksionimin e agregatëve, mirëmbajtjen dhe optimizimin e sistemeve elektronike për monitorimin e energjisë dhe performancën e pajisjeve, zbatimin e teknologjive të avancuara elektronike për të përmirësuar efikasitetin dhe sigurinë e operacioneve.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për mallrat objekt prokurimi.

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

*Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, çertifikatë, deklaratë etj).*

**Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e një Autorizimi nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për mallrat objekt prokurimi është një kërkesë që ka si qëllim të sigurojë se operatori ekonomik ka akses dhe mund të ofrojë produkte të cilësisë së garantuar dhe të sigurta, si dhe të konfirmojë që ato janë në përputhje me standardet e prodhuesit ose distributorit.

Ky kriter ka rëndësi të veçantë për të mbrojtur interesat e kontratës dhe sigurinë e operacioneve të HEC, veçanërisht për mallrat teknike dhe ndihmëse për mirëmbajtjen e agregatëve dhe pajisjeve, siç janë ato mekanike, elektrike dhe elektronike.

**2.3.5** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike.

*Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*

**Argumentimi:**

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

Katalogu teknik është një mjet thelbësor për të verifikuar që mallrat e ofruara janë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike të dokumenteve të prokurimit. Specifikimet teknike përfshijnë parametra të detajuar si përmasat, llojin e materialeve, kapacitetet, performancën dhe funksionalitetet e kërkuara për secilin produkt. Duke ofruar katalogun teknik, operatorët ekonomikë mund të sigurojnë që produktet që ofrojnë, plotësojnë këto kërkesa dhe mund të përdoren në mënyrë efektive për qëllimin e kërkuar.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se mallrat janë të rinj, të pa përdorur.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Me anë të këtyre deklaratave AK krijon bindjen se operatori ekonomik do të përmbush kontratën bazuar në specifikimet dhe kërkesat teknike të kërkuara nga AK, duke garantuar furnizmin me mallra të reja.

Deklarata që mallrat duhet të jenë të rinj dhe të papërdorur është një masë e rëndësishme për të garantuar cilësinë, performancën dhe sigurinë e produkteve që ofrohen në kuadër të një procesi prokurimi. Kjo kërkesë mundëson që produktet të jenë të testuara dhe të certifikuara për përdorim të sigurt dhe të besueshëm, duke minimizuar rreziqet e defekteve, të keqfunksionimeve, dhe të shpenzimeve të papritura për riparime ose rinovime.

**Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

#### **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

*Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:*

Grupi i punës ka ndërmarrë procesin për hartimin e specifikimeve teknike për blerjen e pajisjeve dhe pjesëve rezervë elektrike, elektronike dhe mekanike për HEC Fierzë. Ky proces bazohet në kërkesat specifike të HEC Fierzë për pjesë rezervë me qëllim mirëmbajtjen e agregatëve dhe sistemeve ekzistuese të kontroll-monitorimit, të cilat i janë nënshtruar rehabilitimit të plotë që në vitin 2007. Duke qenë se këto pjesë janë elementë kritikë të sistemeve elektromekanike në punë, parimi kryesor i hartimit të specifikimeve është garantimi i përputhshmërisë së plotë teknike dhe operacionale.

Për këtë arsye, specifikimet teknike si dimensionet dhe parametrat nominalë janë nxjerrë duke marrë për referencë të drejtpërdrejtë pjesët ekzistuese, me qëllim që çdo element i ri të jetë plotësisht i integrueshëm dhe funksional brenda arkitekturës aktuale të sistemit. Edhe pse në dokumentacionin teknik është shënuar emri i prodhuesit të pjesës ekzistuese për qëllime reference dhe identifikimi të standardit të cilësisë, grupi i punës saktëson se mbetet i hapur opsioni për variante ekuivalente nga prodhues të tjerë, me kusht që të plotësohen të njëjtat specifikime teknike dhe performancë. Për identifikimin e saktë të artikujve, çdo artikull është shoqëruar me të dhëna ilustruese përmes fotografive dhe skemave elektrike përkatëse, duke garantuar kështu njohjen e plotë me çdo specifikë të produktit të kërkuar përpara ofertimit.

### **Njësia e Prokurimit**